



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Sektori i Emergjencave Civile

Nr. 197 Prot.

Puke, me 18.10.2023

P/V E N D I M

Nr. 2, Date 18.10.2023

Mbi "Miratimin e objektit "Blerje fadrome" me fondet e akorduara ne programin "Emergjencia Civile"

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Ligji Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar, Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30 shkronja "gj", VKM nr. 414 date 08.07.2021 "Per miratimin e procedurave dhe kriterëve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile", i ndryshuar me VKM nr. 290 date 17.05.2023, shkresën e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr.86/6 dt.21.03.2023 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".

Për sa më sipër, Sektori i Emergjencave Civile, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm si dhe Kryetari i Bashkisë Puke për të marrë masa parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në rruget rurale të territorit të bashkisë Puke, i propozon Këshillit Bashkiak që me shumicë votash:

V E N D O S I :

1. Të miratojë objektin: " Blerje fadrome" nga fondi i akorduar për programin e emergjencave me vlerë **2.700.000 leke** (Dymilion e shtatëqint mijë lekë), me kod produkti 91707AG sipas shkresës së Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm, Sektori i Emergjencave Civile
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenetit 55 pika 6 të ligjit 139/2015 date 17.12.2015 " Për vetëqeverisjen vendore"

Drejtoria e A. Përgjithshëm

Fiqirete LATIFI

P/ Sek. i Emergjencave

Behar ADEMI

JURISTI

Aida SINANI

K R Y E T A R I

Rrok DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Sektori i Emergjencave Civile

Nr. 197/19 Prot.

Puke, me 18 . 10 . 2023

Relacion

Keshillit bashkiak Puke

Lenda: Mbi "Miratimin e objektit "Blerje fadrome" me fondet e akorduara ne programin "Emergjencia Civile"

Ne mbeshtetje te Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar , Ligji Nr.45/2019 "Për mbrojtjen civile", neni 30 shkronja "gj", VKM nr. 414 date 08.07.2021 " Per miratimin e procedurave dhe kriterëve te ndarjes dhe te perdorimit te fondit te kushtezuar te buxhetit te shtetit per mbrojtjen civile , i ndryshuar me VKM nr. 290 date 17.05.2023, shkresën e Agjensisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile Nr 86/6 dt.27.03.2023 "Mbi fondin e kushtëzuar të Buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile".

Me qellim marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbojtese dhe rehabilituese per sezonin vjeshte dimer ku si pasoje e reshjeve te shumta te shirave qe karakterizojne territorin e Bashkise Puke , rrjetin rugor rural ku ne te gjithe periudhen e dimrit rezulton te kete shembje te masiveve te dherave gerryerje demtim te skarpatave eshte e domosdoshme blerja e nje mjeti fadrome per nderhyrje parandaluese per pastrim rruges ne segmentet rrugore rurale, per lehtesim te jetes se bonoreve qe jetojne ne zonat rurale ku shpeshhere nga reshjet e dendura te shirave rezulton te kete demtime te rrugeve dhe here dhe izolim

Mjeti fadrome eshte i domosdoshem per nderhyrje me pastrim ne rastet e bllokimit te rrugeve nga bora si dhe lehtesimin e jetes se banoreve ne kushte te veshtire sociale etj

Fondi per objektin : " Blerje fadrome" eshte i akorduar per programin e emergjencave më vlerë **2.700.000 leke** (Dymilion e shtateqint mijë lekë) , me kod produkti 91707AG sipas shkresës së Agjensise Kombetare te Mbrojtjes Civile.

P/ Sek. i Emergjencave


Behar ADEMI

KRYETARI

Rrok DODAJ



MIRATOHE
KRYETARI
Rrok DODAJ



PREVENTIV

Objekti : Blerje Fadrome
Bashkia Puke
data 16.10.2023

Nr.	EMERTIMI	Njesia	Sasia	Cmimi/njesi	Vlera/lek
1	Fadrome	cop	1	2.700.000	2.700.000
			SHUMA ME TVSH		2.700.000

Specifikimet bashkelidhur preventivit

Preventivoj

Behar Ademi

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Behar Ademi', is written below the name.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E MBROJTJES
AGJENCIA KOMBËTARE E MBROJTJES CIVILE

Tiranë, më 27.3.2023

prot. 2016
statusi: Urgjent

Lënda: Mbi fondin e kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile.

BASHKIA PUKË

Pukë

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, bazuar ligjit 45/2019, "Për mbrojtjen civile", përkatësisht kreu II, neni 8, shkronja ç, kreu II, neni 23, shkronja d dhe neni 15 të ligjit 84/2022 "Për buxhetin e vitit 2023", në kuadër të ushtrimit të detyrave funksionale, ju informon se:

Fondi i akorduar, në programin "Emergjecat civile" të Ministrisë së Mbrojtjes i cili do të shpërndahet për njësitë e vetëqeverisjes vendore nga Ministria e Mbrojtjes, në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me një formulë, e cila bazohet në peshën specifike që zë buxheti i çdo bashkie ndaj totalit të buxhetit të të gjitha bashkive, është përlogaritur për Bashkinë Pukë në masën 3,232,606.72 lekë.

Për vitin 2023 në degën e thesarit për Artikullin 604, janë funksional dy kode si më poshtë vijon:

1. Kodi i produktit 91707AG - "Shpenzime për marrjen e masave parandaluese, lehtësuese mbrojtëse dhe rehabilituese në objekte të ndryshme, nëpërmjet blerjes së materialeve dhe shërbimeve të ndryshme për mbrojtjen e jetës dhe pronës së njerëzve".
2. Kodi i produktit 91707AB - "Shtetas të ndihmuar banesat e të cilëve janë dëmtuar nga fatkeqësi të ndryshme".

Për sa më sipër, me qëllim përdorimin e fondit të kushtëzuar në kuadër të reduktimit të riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, kërkojmë nga ana juaj ndarjen e masës që do të përdoret sipas fondit në sidpozicion.

Informacioni i kërkuar, duhet të na disponohet brenda datës 30.03.2023, në rast të kundërt nuk do mund të realizohet alokimi i fondit.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin,

DREJTORIA PËR GJITHSHËM
Haki Cako